



Gama e Baterive - Përmbledhje

Gama e EnerSys® e baterive PowerSafe® SBS vazhdon të ofrojë zgjedhje dhe performancë të pakonkurrueshme për konfigurime kompakte dhe energji të dendur. Bateritë PowerSafe SBS janë prodhuar sipas standardeve më të larta ndërkombëtare dhe janë ideale për përdorim të besueshëm në të gjitha aplikimet e komunikacioneve celulare dhe me linjë fikse. Bateritë PowerSafe SBS përdoren gjerësisht edhe në televizionin kabllor, ndriçimet e emergjencës, prodhimin e energjisë dhe përdorime në det.

Gama e baterive PowerSafe SBS është e disponueshme në një sërë variantesh, duke përfshirë serinë me terminale përpara, e cila është bërë shumë e pëlqyeshme në përdorimet më të përparuara të telekomunikimit. Me një madhësi më të vogël se modelet e konkurrencës, ndërtimi i serisë me terminale përpara ofron fleksibilitet më të madh aty ku hapësira është e kufizuar dhe bën që instalimi dhe mirëmbajtja të jenë më të lehta dhe të shpejta.

Bateritë PowerSafe SBS janë projektuar që të përballojnë temperatura të larta dhe mjedise të vështira. Teknologjia e avancuar me pllakë plumbi të pastër dhe metodat unike të prodhimit të përdorura nga EnerSys, bëjnë që bateritë PowerSafe SBS të jenë zgjedhja e parë për shërbim jetëgjatë dhe pa defekte. Temperatura maksimale e funksionimit të serisë së baterive PowerSafe SBS mund të rritet deri në 80°C përmes një veshjeje metalike opsionale.

Vetitë dhe avantazhet

- Diapazoni i kapacitetit: 7Ah - 360Ah
- Konfigurime 2V, 6V, dhe 12V
- Dendësi e lartë energjie
- Jetëgjatësi përdorimi e madhe
- Kohë ruajtjeje deri në dy vjet
- Diapazoni i gjerë i temperaturës së funksionimit: -40°C deri +50°C



Konstruksioni

- Plakat pozitive - rrjeta prej plumbi të pastër të prodhuar nëpërmjet një procesi unik
- Plakat negative - sigurojnë ekuilibër perfekt me plakat pozitive për të garantuar efikasitet optimalë rikombinimi
- Veçuesit - veçues me veshje qelqi mikroporoze të cilësisë superiore me përthithje dhe stabilitet të lartë
- Kutitë dhe kapakët - me material rezistent ndaj flakës dhe klasifikim UL94 V-0, tepër rezistent ndaj goditjeve dhe dridhjeve (Tipet J janë me rrëshirë PPE+PS, të gjitha të tjerat janë me ABS)
- Elektroliti - acid sulfurik i shkallës së lartë i holluar, i absorbuar në materialin veçues
- Dizajni i terminalit - dizajn terminali me izolim të dyfishtë të patentuar, rezistent ndaj rrjedhjes
- Valvula sigurie me vetërregullim të presionit - pengojnë hyrjen e oksigjenit atmosferik
- Pengues flakësh - të integruar në çdo bllok për një siguri më të lartë funksionimi

Instalimi dhe funksionimi

- Bateritë PowerSafe® SBS janë projektuar për instalim në kabine ose rafta, afër pikës së përdorimit. Nuk nevojitet një sallë e veçantë për bateritë
- Pilat dhe modulet monoblok mund të montohen në çfarëdo drejtimi, duke përjashtuar pozicionin përmbys.
- Tensioni i rekomanduar i karikimit plotësues: 2,29Vpc në 20°C (68°F) ose 2,27Vpc në 25°C (77°F)
- Kohë ruajtjeje deri në dy vjet
- Nevojë e ulët për mirëmbajtje: nuk kërkohet shtimi i ujit
- Disa tipe të baterive PowerSafe SBS disponohen edhe për përdorime nënujore

Standardet

- Projektuar për t'u përpunuar me standardin ndërkombëtar IEC 60896/21 & 22
- Klasifikuar si "Jetëgjatësi Shumë e Madhe" (> 12 vjet) sipas Udhëzuesit të Eurobat 2015
- E njohur nga UL (Standardi UL 1989)
- Miratuar si ngarkesë që nuk rrjedh për transport tokësor, detar dhe ajror, në përputhje me Rregulloren 49 të Departamentit të Transportit të SHBA-së (USDOT) dhe Udhëzuesin e Paketimit 872 të ICAO (Shoqata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil) dhe IATA (Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror)
- Sistemet e menaxhimit që rregullojnë prodhimin e produkteve PowerSafe SBS janë certifikuar nga ISO 9001:2008 dhe ISO 14001:2004

Specifikimet e përgjithshme

Tipi i baterisë	Tensioni nominal (V)	Kapaciteti nominal (Ah)		Përmasat nominale (mm)			Peshat tipike (kg)	Rryma e lidhjes së shkurtër (A) ⁽²⁾	Rezistenca e brendshme (mΩ) ⁽²⁾	Terminalet
		10 orë në 1,80 Vpc në 20°C	8 orë në 1,75 Vpc në 77°F	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia				
SBS 8	12	7	7	138	86	99	2,7	455	27,1	2 x M4 F
SBS 15	12	14	14	200	77	140	5,2	891	13,5	2 x M6 M
SBS 30	12	26	26	250	97	156	9,5	1556	7,9	2 x M6 M
SBS HB30 ⁽¹⁾	12	26	26	250	97	156	9,6	1556	7,9	pajimet
SBS 40	12	38	38	250	97	206	13,2	2184	5,6	2 x M6 M
SBS 60	12	51	51	220	121	261	18,5	2618	4,4	2 x M6 M
SBS 110	6	115	116	200	208	239	21,2	3804	1,7	2 x M8 M
SBS 130	6	132	133	200	208	239	22,7	4111	1,4	2 x M8 M
SBS 300	2	310	307	200	208	239	21,7	8700	0,23	2 x M8 M
SBS 390	2	360	361	200	208	239	23,2	11101	0,18	4 x M8 M
SBS J13 ⁽³⁾	12	12	12	175	83	129	5,2	957	13,0	2 x M6 F
SBS J16 ⁽³⁾	12	15	15	181	76	167	6,7	1111	11,0	2 x M6 F
SBS J30 ⁽³⁾	12	26	26	166	175	125	11,8	1766	7,0	2 x M6 F
SBS J40 ⁽³⁾	12	39	39	197	165	170	15,9	2400	5,2	2 x M6 F
SBS J70	12	64	64	329	166	174	27,6	3500	3,5	2 x M6 F
SBS B8	12	31	31	280	97	159	10,3	1270	10,0	2 x M8 F
SBS B8F	12	31	31	303	97	159	10,3	1270	10,0	2 x M6 M
SBS B10	12	38	38	280	97	184	11,8	1390	9,0	2 x M8 F
SBS B10F	12	38	38	303	97	184	11,8	1390	9,0	2 x M6 M


Shënime:

⁽¹⁾ Bateria SBS HB30 është pajisur me një pajim lidhjeje 533 mm/21 inç, në fundin e së cilës është një bashkues mashkull me 2 kunjë, që përputhet me sistemet e integruara SLIC.


⁽²⁾ Shifra të marra me metodën IEC.

⁽³⁾ Për tipet SBS J disponohen veshje metalike opsionale. Për të porositur një tip SBS J me veshje metalike, shtoni "X" pas numrit të modelit (p.sh. "SBS J13X").


Vizatimet e kontureve




Tipet SBS 8 deri 60
Tipet SBS J



SBS 110-390
tipet



SBS B8 & B10
tipet



SBS B8F & B10F
tipet



www.enersys.com

Zyrat qendrore të EnerSys 2366 Bernville Road, Reading, PA 19605, USA Tel: +1-610-208-1991 / +1-800-538-3627

EnerSys EMEA EH Europe GmbH, Baarerstrasse 18, 6300 Zug, Switzerland

EnerSys Asia 152 Beach Road, Gateway East Building Level 11, 189721 Singapore Tel: +65 6508 1780

© 2015 EnerSys. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Markat tregtare dhe logot janë pronë e EnerSys dhe filialeve të saj, përveç ISO, që nuk është pronë e EnerSys.

Objekt i rishikimit pa njoftim paraprak. E.&O.E.

EN-SBS-RS-011 - Gusht 2015